



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 30 gusht 2013

Numri i lëndës: 2013-02

Arsim Krasniqi

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 dhe 30 gusht 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 19 shkurt 2013.

II. FAKTET

2. Në një datë të pasaktësuar, ankuesi ishte dënuar për vrasje dhe dënuar me njëzet vite burgim. Ai është i burgosur që prej datës 21 janar 2007, fillimisht në Qendrën Korrektuese në Dubravë.
3. Më 28 shkurt 2012, ai ishte transferuar në Qendrën për Paraburgim në Prizren. Ai pretendon se arsyeja e transferimit të tij kishte qenë se ishte dyshuar për posedim jo të ligjshëm të armëve. Ai konstaton se kur ishte transferuar nuk ju ishte lejuar që t'i merrte me vete gjësendet e veta personale.
4. Ankuesi pohon se që prej atëherë ai ishte transferuar edhe tre herë të tjera midis qendrave të ndryshme të paraburgimit.
5. Që nga data 3 shtator 2012 ankuesi është mbajtur në Qendrën për Paraburgim në Pejë. Ai pretendon se gjësendet e tij personale kishin humbur gjatë transferimit të tij të fundit. Po ashtu ai pohon se po mbahet në qeli me persona të paraburgosur.

III. ANKESAT

6. Ankuesi pohon se është duke u ngacmuar dhe diskriminuar nga autoritetet e burgut. Ai ankohet se është transferuar nëpër burgje pa ndonjë mundësi për të parashtruar ankesë kundër vendimeve për transferim. Po ashtu ai pohon se mbajtja e tij në të njëjtën qeli me personat e tjerë të paraburgosur përbën shkelje të të drejtave të tij të njeriut.

IV. LIGJI

7. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
9. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë me keqtrajtimin e supozuar të tij në burg. Ankesa i bie të shqyrtohet sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtën e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Evropiane) e cila thotë si në vijim:

Neni 3

Ndalimi i torturës

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës.

10. Paneli së pari konstaton se mund të shqyrtojë vetëm ankesat e parashtruara brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar, siç përcaktohet në rregullën 25, paragrafin 3 të rregullores së punës. Prandaj kur shqyrton këtë pjesë të ankesës në fjalë, Paneli nuk do të shqyrtoj ndonjë shkelje të pohuar të të drejtave të ankuesit, të cilat thuhet të ketë ndodhur para datës 19 gusht 2012.
11. Për atë që ankuesi mund të thuhet se ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur pas asaj date, Paneli konstaton se nuk është argumentuar e lerë më treguar se EULEX-i ishte i përfshirë në ndonjë mënyrë në atë çfarë ankuesi e përshkruan si shkelje të të drejtave të tij. Del nga kjo se çështjet e ngritura nga ankuesi nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Si pasojë, ato janë jashtë mandatit të Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (krahaso, *Halili kundër EULEX-it*, nr. 2012-08, 15 janar 2013 par. 24 e tutje). Paneli mund ta shpall ankesën të papranueshëm vetëm mbi këtë bazë.
12. Në çfarëdo rasti, lidhur me thelbin e ankesës, Paneli vëren se keqtrajtimi duhet të arrijnë nivelin minimal të ashpërsisë në qoftë se duhet të hyjë në kuadër të nenit 3 (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 18 janar 1978, Seria A nr. 25, fq. 65, § 162, ose *Iwańczuk kundër Polonisë*, nr. 25196/94, § 50, 15 nëntor 2001). Sa i përket torturës, aty kërkohet demonstrim i trajtimit të qëllimshëm çnjerëzor që sjell vuajtje shumë serioze dhe mizore të shkaktuara me qëllim që të arrihet një nga synimet e ndaluara, të cilat janë të njohura (shih, p.sh. *El Masri kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], nr. 39630/09, § 197, dhe autoritetet e cituar aty).
13. Ankuesi pohon se është mbajtur në një qeli me persona të paraburgosur. Ai nuk arrin të tregoj se si kjo përbën ndonjë lloj keqtrajtimi të paraparë në nenin 3. Sa i përket humbjes së pretenduar të gjësendeve personale të ankuesit, Paneli është i mendimit se edhe pse kjo ndoshta ka mundur t'i shkaktoj ankuesit ca shqetësime, ky incident nuk mund të thuhet se ka shkaktuar vuajtje të cilat do të përbënin trajtim çnjerëzor e poshtëruës apo torturë. Për më tepër, Paneli nuk ka asnjë informacion se kjo ishte bërë qëllimisht, e as që autoritetet, nëse janë marrë me këtë çështje, kanë dështuar të veprojnë me kujdes dhe në kohën e duhur në trajtimin e kësaj çështjeje.
14. Prandaj Paneli konsideron se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi, e cila do ta lejonte atë të nxjerr si përfundim se trajtimi për çka ankohet ai përbën trajtim çnjerëzor ose poshtëruës apo torturë sa i përket kuptimit të nenit 3 të Konventës Evropiane. Bazuar në informacionin në dispozicion të Panelit, ankesat për këtë arsye janë të pabaza.
15. Paneli më në fund konstaton se ankuesi mund të ngrit çfarëdo çështje lidhur me akuzat për keqtrajtim tek autoritetet kompetente të prokurorisë.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, gjen se ankesa është e pabazuar sipas nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese